



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 700/5 prot.

Tiranë më 30.05.2018

REKOMANDIM

Nr. 20, datë 30.05.2018

PËR KONTROLLUESIN

(PERSON FIZIK)

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit " (person fizik)",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 131 datë 30.04.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit " (p.f.)" me objekt aktiviteti Klinikë Dentare, me objekt kontrolli:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar dhe zbatimi i Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit " (p.f.)".

Në funksion të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", klinikat dentare janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale për kategoritë "punonjës", "pacientë" dhe "vizitorë".

Kontrolluesi " (p.f.)" është subjekt juridik me NIPT: K71805003A dhe ka fushë veprimtarie "Klinikë Dentare".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit.
Zyra e Komisionerit vëren se, konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

i ndryshuar: *“Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës...”*.

2. Kontrolluesi disponon një sistem video-vëzhgimi (CCTV) të përbërë nga DVR (video regjistruar digjital) dhe katër kamera. Qëllimi i përdorimit të këtij sistemi është garantimi i sigurisë në ambientin e punës. Nëpërmjet këtij sistemi, kontrolluesi mbikëqyr një pjesë të korridorit të jashtëm të klinikës, recepsionin dhe ambientin në të cilin ushtron veprimtarinë klinike/dentare.

Kamera e cila është vendosur në hyrje të klinikës, mbikëqyr një pjesë të korridorit duke përfshirë pjesërisht hyrjen e zyrës së ankuesit e cila ndodhet në distancë 2.5 metra nga hyrja e ambientit të kontrolluesit. Referuar provave të administruara, imazheve të marra nga sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), konstatohet se kamera e jashtme mund të vëzhgojë hyrjen e kësaj zyre, çka bën të mundur identifikimin dhe për pasojë cënim të privatësisë të subjekteve të të dhënave të cilët hyjnë apo dalin në këtë zyrë.

Përpunimi i të dhënave *“imazhe-video”* të subjekteve të të dhënave *“pacientë”* gjatë dhe në kontekst të trajtimit të tyre mjekësor/dentar, është e dhënë sensitive referuar përcaktimit në pikën 4 të nenit 3 të ligjit. Mbikëqyrja nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), të ambientit në të cilin ushtrohet veprimtaria klinike, nuk është në përputhje me qëllimin e vendosjes së këtij sistemi. Aplikimi i këtij sistemi duhet të përkojë vetëm me atë çfarë është absolutisht e domosdoshme për kontrolluesin por pa kufizuar në mënyrë jo-proporcionale të drejtën e subjektit të të dhënave.

Akses në sistemin e video-survejit (CCTV) ka zj. . Në rast defektesh, akses lokal në sistem mund të ketë specialisti i kompanisë që ka bërë instalimin e pajisjes, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesit të kontrolluesit. Aksesimi i pajisjes DVR kryhet nëpërmjet rrjetit nga kompjuteri i cili i shërben kontrolluesit gjithashtu edhe si mjet për përpunimin e të dhënave të pacientëve. Koha e ruajtjes së të dhënave *“imazhe-video”* në sistemin e video-vëzhgimit (CCTV) konstatohet të jetë 90 ditë.

Zyra e Komisionerit vëren se, konstatimet përbëjnë shkelje administrative të neneve të neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 23/2012 të Komisionerit, mbi *“Përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”*, kreu VII, pika 5: *“Nëse nuk ka përdorime të mëtejshme, regjistrimi fshihet brenda 3 ditë pune pas regjistrimit...”*

3. Në hyrje të ambienteve, kontrolluesi ka vendosur një tabelë informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), por ajo nuk është sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vëren se, mungesa e informimit të subjekteve të të dhënave lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 18 (pika 1) të Ligjit: *“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale.*

4. Kontrolluesi nuk ka publikuar politikat e privatësisë në portalin zyrtar www.klinikanevsmile.com.

Zyra e Komisionerit vëren se, konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit pika 1 - "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...".

Në cilësinë e provës materiale, Zyra e Komisionerit ka administruar dokumentet e mëposhtme:

1. Fotografi të marra nga sistemi i video-vëzhgimit (CCTV) të kontrolluesit.
2. E-maili i ankuesit Dh.D. dërguar në adresën e postës elektronike info@klinikanewsmile.com (të publikuar në portalin zyrtar www.klinikanewsmile.com të kontrolluesit) dhe dërguar për dijeni në postën elektronike info@idp.al të Zyrës së Komisionerit.
3. Ekstrakt historik i biznesit nga QKB;
4. Printim nga portali www.klinikanewsmile.com.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, është mbajtur procesverbali në prezencë të përfaqësueses së kontrolluesit. Lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit, përfaqësuesja e kontrolluesit praqiti pretendimet me shkrim nëpërmjet shkresës nr. 700/3 prot. datë 04.05.2018, ndër të cilat dokumenton se ka përmbushur detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale si dhe ka marrë masa teknike dhe organizative për kufizimin e kohës së ruajtjes së të dhënave imazhe video në sistemin e video-vëzhgimit (CCTV), ndryshimin e pozicionit të vëzhgimit të kameras në hyrje të klinikës (duke shmangur mbikëqyrjen e ambienteve të cialt nuk i përkasin), heqjen e kamerave nga ambienti në të cilin kryen trajtimet klinike ndaj pacientëve si dhe informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelës informuese të miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje të dispozitave 5, 6, 7, 12, 18 dhe 21 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" si dhe Udhëzimit nr. 23/2012 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë". Nisur nga fakti që kontrolluesi u tregua bashkëpunues me grupin e kontrollit dhe i gatshëm për riparimin e menjëhershëm të shkeljeve, Zyra e Komisionerit vlerëson se dalja me akt rekomandues plotëson më së miri përfundimin e këtij kontrolli.

Për sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 6, 7, 12, 18, 21, 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi " ", në zbatim të neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të ndalojë mbledhjen/arshivimin e të dhënave "imazhe-video" përtej afatit të parashikuar në Udhëzimin nr. 23/2012 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë";
2. Kontrolluesi " ", në zbatim të nenit 12 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ti mundësojë aksesin në të

dhënat personale të mbledhura çdo kërkuesi të cilit të dhënat "imazhe-video" i përpunohen nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (CCTV). Kontrolluesi duhet të marrë masa të përshtatshme, nëse do të jetë rasti nëpërmjet anonimizimit, në mënyrë që të garantojë privatësinë e pacientëve apo individëve të tjerë.

3. Kontrolluesi " ", në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të hartojë dhe publikojë politikat e privatësisë në portalin zyrtar www.klinikanevsmile.com.
4. Kontrolluesi " ", të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë Rekomandim brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 30.05.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

